

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

**SHËRBIME KUJDESI PËR
KAFSHË**

**Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)**

(Në drejtimin mësimor “Bujqësi”)

Kodi: H9-III-20

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2020

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Bujqësi”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimet të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Bujqësi”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me punimet dhe shërbimet e kujdesit për kafshë”*. Zhvillimi te nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional të profilit “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MFE përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të respektojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.
- Të kujdeset për mirëqenien e kafshëve të fermës.
- Të kryejë dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e stallave.
- Të kujdeset për riprodhimin e kafshëve të fermës.
- Të kujdeset për kafshën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurin.
- Të zbatojë masa të përgjithshme profilaktike të kafshët e fermës.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë drejtim profesional. Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punonjës i kualifikuar në ndërmarrje/ferma të ndryshme blegtorale ose veprimtari të tjera që veprojnë në fushën e rritjes së kafshëve dhe shpendëve. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në këtë fushë. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Bujqësi”, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për profilin mësimor “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-19-502-19	Bazat e veterinarisë	2
3	L-28-503-19	Kujdesi dhe mirëqenia e kafshëve	2
4	L-28-204-19	Riprodhimi i kafshëve	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-28-1555-19	Shërbime kujdesi për mirëqenien e kafshëve	81
2	M-28-1556-19	Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i mjediseve	81
3	M-28-1557-19	Shërbime kujdesi për riprodhimin e kafshëve të fermës	81
4	M-28-1558-19	Shërbime kujdesi për kafshën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurit	84
5	M-28-1559-19	Zbatimi i profilaxisë së përgjithshme në kafshët e fermës	81
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-28-555-19	Trajtimi i kafshëve për prodhim qumështi e mishi	51
2	M-28-1560-19	Kujdesi për shpendët dekorativ dhe kafshët e shoqërimit	51
3	M-28-1561-19	Metodat e fiksimit të kafshëve	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “*të nxënësit duke bërë*” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Shërbime kujdesi për kafshë”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për

lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;

b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e kujdesit për kafshë, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime kujdesi për kafshë”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;

- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë

Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë

2. Lënda “Bazat e veterinarisë” (L-28-502-19) Kl.12-68 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e veterinarisë” kl.12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e veterinarisë” kl.12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë thelbin dhe natyrën e sëmundjes në përgjithësi.
- Të analizojnë shkaqet dhe faktorët që kushtëzojnë përhapjen e sëmundjes.
- Të përshkruajë konceptin e profilaksisë kundër sëmundjeve infektive;
- Të shpjegojë llojet e profilaksisë për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme në një fermë blegtorale;
- Të listojë masat që duhen pasur parasysh në profilaksinë e përgjithshme;
- Të argumentojë zgjedhjen e vendit për ndërtimin e stallave dhe materialet për ndërtimin e strehimeve të kafshëve bujqësore;
- Të identifikojë burimet e infeksionit të kafshët;
- Të shpjegojë dezinfektimin si një proces me rëndësi të madhe praktike;
- Të krahasojë llojet dhe metodat kryesore të dezinfektimit;
- Të analizojë karakteristikat e përgjithshme të lëndëve dezinfektuese;
- Të argumentojë faktorët e përcaktimit të shkallës së veprimit të dezinfektantëve;
- Të argumentojë masat për profilaksinë e veçantë;
- Të krahasojë karantinën me izolimin;
- Të shpjegojë masat e tjera parandaluese si: kushtet për kafshët e sëmura, personelin e duhur, asgjësimin e kufomave, grumbullimi e përpunimi biotermik i plehut etj.;
- Të listojë rekomandimet për kontrollin e kafshëve për të shmangur shpërthimet e sëmundjeve në tufë;
- Të listojë mënyrat e asgjësimit të kafshëve, materialeve dhe mbeturinave me djegie;
- Të shpjegojë rëndësinë e dezinfektantëve në ujë të pijshëm, në parandalimin e transmetimit të mikrobeve përmes ujit;
- Të shpjegojë rëndësinë e dezinfektimeve për kafshët dhe punonjësit në parandalimin e transmetimit të sëmundjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e masave veterinare, për mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të përbashkëta për njerëz dhe kafshë;
- Të dallojnë llojet e pezmatimeve në bazë të shenjave klinike;
- Të përshkruajnë mënyrën e kontrollit të përgjithshëm të kafshës;
- Të konstatojnë humbjet dhe dëmet ekonomike të shkaktuara nga sëmundjet;
- Të përshkruajnë mënyrat dhe metodat e parandalimit të sëmundjeve;
- Të përshkruajnë se si mjekohet një kafshë e sëmurë;

- Të përshkruajnë se si mbahet dokumentacioni veterinar;
- Të përshkruajnë masat profilaktike të tilla si: dezinfektimi i stallës dhe i territorit përreth, vaksinimet, provat e diagnostikimit etj;
- Të tregojnë metodat e egzaminimit për çdo aparat të kafshës;
- Të krahasojnë gjendjen normale dhe patologjike të kafshës pas kontrollit;
- Të tregojnë teknikat dhe metodat e fiksimit në kafshë të ndryshme;
- Të theksojnë mënyrat e ndryshme të injektimit të barnave në kafshë;
- Të grupojnë sëmundjet sipas aparateve në kafshë;
- Të theksojnë shenjat klinike për sëmundje të ndryshme;
- Të dallojnë sëmundjet infektive nga ato parazitare;
- Të dallojnë shenjat klinike në mastite;
- Të dallojnë shenjat klinike në pjelljet e vështira;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat veterinarisë”, kl. 12 – 68 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për veterinarinë	2 orë
Tema 2	Koncepti mbi sëmundjen	6 orë
Tema 3	Pezmatimi dhe llojet e tij	4 orë
Tema 4	Njohuri të përgjithshme mbi autopsinë	5 orë
Tema 5	Infeksioni dhe qëndresa e organizmit ndaj infeksionit	8 orë
Tema 6	Profilaksia e përgjithshme dhe e veçantë	8 orë
Tema 7	Metodat e përgjithshme të egzaminimit	4 orë
Tema 8	Ekzaminimi i kafshës së sëmurë	6 orë
Tema 9	Metodat e fiksimit dhe injeksionet në kafshë	6 orë
Tema 10	Plagët kirurgjikale	8 orë
Tema 11	Sëmundjet ordinere në kafshët bujqësore	4 orë
Tema 12	Sëmundjet infektive dhe parazitare në kafshët bujqësore	7 orë

3. Lënda “Shërbime kujdesi për kafshë” (L-28-503-19) Kl. 12 – 68 orë

• **Synimet e lëndës “Kujdesi dhe mirëqenia e kafshëve”, kl. 12 – 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kujdesi dhe mirëqenia e kafshëve” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojë mirëqenien për kafshët dhe rëndësinë e saj;
- Të listojë pesë liritë, mbi bazën e të cilave vlerësohet mirëqenia e kafshëve në çdo sistem blegtoral;
- Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve në kafshë, në përshtatje me qëllimin e mbajtjes së tyre, në përputhje me nevojat e tyre fiziologjike dhe veçoritë e llojit;
- Të listojë kompetencat që duhet të ketë një personel shërbimi tek kafshët e fermës lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e tyre, procedurën e marrjes së certifikatave shëndetësore, lejeve për eksport të kafshëve të gjalla dhe nënprodukteve të tyre (lëkura, leshi etj.);
- Të listojë shenjat e kafshëve në një situatë jo normale lidhur me shëndetin gjatë inspektimit;
- Të listojë llojet e sjelljeve të kafshëve dhe shenjat kryesore në këto sjellje (sjellje seksuale, sjellje të ikjes, sjellja e mbrojtjes, sjellja shoqërore, sjellje në situata stresuese);
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit me kafshët ,si një pjesë e rëndësishme për të vlerësuar gjendjen emocionale të kafshës dhe temperamentin e tij,por edhe për të mbrojtur vehten nga plagosjet ndaj vehtes, aftësitë e komunikimit të grupeve të veçanta të kafshëve.

- Të shpjegojnë karakteristika të sjelljes në kafshë të veçanta si: gjedhë, derra, kuaj, shpendë shtëpiak, qen e mace.
- Të shpjegojnë rolin dhe funksionin e sjelljes riprodhuese.
- Të shpjegojnë mënyrën e projektimit, ndërtimit të strehimit dhe vendosjes së pajisjeve të ushqimit dhe ujit për mos ndotjen e ushqimit dhe ujit në lidhje me mirëqenien e kafshëve;
- Të shpjegojnë mënyrën e projektimit, ndërtimit të strehimit dhe vendosjes së pajisjeve të ushqimit dhe ujit për minimizimin e konkurrencës ndërmjet kafshëve për sisteme të ndryshme mbarështimi;
- Të përshkruajë cilësitë dhe sasinë e ujit të pijshëm për furnizimin e kafshëve;
- Të shpjegojnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit përkatës për shëndetin dhe higjienën e kafshëve;
- Të shpjegojnë kushtet për hapësirat e strehimeve të kafshëve sipas llojit dhe kategorive të tyre, numrit të tyre në grupe, seksit, peshës, nevojave të sjelljes;
- Të përshkruajë kushtet e dyshemesë apo vendqëndrimeve lidhur me mirëqenien e kafshëve gjatë qëndrimit dhe lëvizjeve të tyre në vendstrehim;
- Të listojë faktorët në ndryshimin e mikroklimës të vendstrehimit;
- Të shpjegojnë nivelet dhe korigjimet e faktorëve të mikroklimës në stallë për mos dëmtimin e kafshëve;
- Të shpjegojnë faktorët ndikues në ventilimin e strehimeve të kafshëve, domosdoshmërinë e ndriçimit natyral dhe artificial në kushte stalle;
- Të shpjegojnë kushtet e mbarështimit të lirë të kafshëve në natyrë lidhur me mirëqenien e tyre;
- Të listojë teknikat për identifikimin dhe trajtimin e kafshëve për të kufizuar stresin;
- Të shpjegojnë rëndësinë e mirëqenies së kafshëve të egra;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kujdesi dhe mirëqenia e kafshëve”, kl. 12 – 68 orë**

Tema 1	Objekti dhe rëndësia e kujdesit dhe mirëqenies së kafshëve	3 orë
Tema 2	Mirëqenia e kafshëve bujqësore	5 orë
Tema 3	Personeli shërbimit në kafshët e fermës	6 orë
Tema 4	Klasifikimi dhe zhvillimi i sjelljes	6 orë
Tema 5	Komunikimi i kafshëve	8 orë
Tema 6	Efektet e mbajtjes së kafshëve në mjedise të mbyllura	7 orë
Tema 7	Karakteristikat e sjelljes së grupeve të veçanta	6 orë
Tema 8	Sjellja riprodhuese e kafshëve	7 orë
Tema 9	Akomodimi në mbarështimin e kafshëve bujqësore	6 orë
Tema 10	Strehimet blegtorale dhe mjedisi në fermë	6 orë
Tema 11	Ambjenti dhe shëndeti	4 orë
Tema 12	Mirëqenia e kafshëve të egra	4 orë

4. Lënda “Riprodhimi i kafshëve” (L-28-204-19) Kl. 12 - 34 orë

• **Synimet e lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 12 – 34 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Riprodhimi i kafshëve” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e studimit të riprodhimit të kafshëve dhe ndërtimin anatomik të organeve gjinore femërore dhe mashkullore.
- Të përshkruajnë funksionin dhe fiziologjinë e organeve gjinore femërore dhe mashkullore.
- Të krahasojnë ndërtimin e organeve gjinore femërore në kafshë të ndryshme.

- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik të gjirit te lopët dhe të përshkruajë fiziologjinë e gjirit.
- Të tregojnë veçoritë anatomike të gjirit te kafshët e tjera bujqësore.
- Të tregojnë kuptimin e pjekurisë seksuale dhe asaj trupore të kafshëve.
- Të diferencojnë pjekurinë seksuale nga ajo trupore.
- Të përkufizojnë çfarë është cikli seksual.
- Të përshkruajnë periudhat e ciklit seksual.
- Të tregojnë karakteristikat e ciklit seksual te kafshët bujqësore.
- Të përshkruajnë ndryshimet e organeve gjinore tek kafshët në afsh.
- Të përshkruajnë ndërzimin si një proces reflektor.
- Të theksojnë rëndësinë praktike të njohjes së reflekseve seksuale.
- Të tregojnë mënyrat e ndërzimit.
- Të përshkruajnë periudhat e procesit të pllenimit.
- Të përshkruajnë periudhat e zhvillimit embrional.
- Të përshkruajnë ndryshimet anatomike dhe fiziologjike te kafshët barsë.
- Të përshkruajnë zgjatjen e mbarsmërisë në kafshë të ndryshme.
- Të tregojnë kujdesin për kafshën barse.
- Të përkufizojnë procesion e pjelljes.
- Të përshkruajnë shenjat paralajmëruese të pjelljes.
- Të përshkruajnë fazat e procesit të pjelljes.
- Të tregojnë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes.
- Të përshkruajnë trajtimin e kafshëve pas pjelljes dhe trajtimin e të porsalindurve.
- Të përkufizojnë çfarë janë dështimet në kafshë.
- Të përcaktojnë shkaqet dhe llojet e dështimeve në kafshë.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në pjelljet e vështira.
- Të përshkruajnë metodat gjatë ndërhyrjeve në pjelljet e vështira
- Të përshkruajnë disa nga sjelljet jonormale të riprodhimit tek kafshët meshkuj e femra si dhe çrregullime të sjelljes mëmësore(refuzimi i të voglit,kanibalizmi etj)
- Të rendisin shkaqet që çojnë në shfaqjen e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë tek kafshët e porsalindura.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në kafshët e porsalindura me asfiksi, ftohje trupore, hipoglicemi.
- Të përcaktojnë masat parandaluese dhe mjekimin për patologjitë e kafshëve të porsalindura.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 12 – 34 orë**

Tema 1	Rëndësia dhe objekti i riprodhimit të kafshëve	1 orë
Tema 2	Fiziologjia e organeve gjinore femërorë dhe mashkullore	4 orë
Tema 3	Anatomia dhe fiziologjia e gjirit	3 orë
Tema 4	Pjekuria seksuale, trupore dhe cikli seksual	3 orë
Tema 5	Ndërzimi dhe pllenimi i kafshëve	5 orë
Tema 6	Mbarsmëria dhe pjelljet në kafshë	5 orë
Tema 7	Kujdesi dhe trajtimi i kafshëve para dhe pas pjelljes	6 orë
Tema 8	Anomalitë e sjelljeve riprodhuese	4 orë
Tema 9	Sëmundjet e kafshëve të porsalindura.	3 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli: “Shërbime kujdesi për mirëqënien e kafshëve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	SHËRBIME KUJDESI PËR MIRËQËNIEN E KAFSHËVE	M-28-1555-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer akomodimin e përshtatshëm të kafshëve, të ushqyerit e tyre në lidhje me mirëqënien, si dhe të kujdeset për shëndetin mendor dhe fizik të tyre në harmoni me mjedisin.	
Kohëzgjatja e modulit	81 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit akomodimin e përshtatshëm për mirëqënien e kafshës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve.– Të përzgjedhë mjetet dhe vendin për akomodimin e përshtatshëm të kafshës, duke zbatuar kushtet për strehimet e tyre sipas llojit, numrit në grupe, peshës, nevojave të sjelljes.– Të sigurojë hapësirën e nevojshme në përputhje me nevojat fiziologjike dhe etologjike, për mënjanimin e stresit, vuajtjeve dhe dëmtimeve.– Të pastrojë vendqëndrimet e kafshëve sipas llojeve dhe kategorive të kafshëve.– Të pastrojë vendkalimet e kafshëve sipas llojeve dhe kategorive.– Të sigurojë dysheme të pastër, të thatë në vendqëndrimet e kafshëve sipas llojit të shtresave.– Të sigurojë ventilim të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit në përputhje me llojin, peshën trupore, numrin e kafshëve.– Të sigurojë ndriçim të mjaftueshëm natural dhe artificial në strehimet e kafshëve.– Të vendosë kafshët në strehime në përputhje me llojin,	

numrin në grupe, seksit, peshës, nevojave të sjelljes duke mundësuar shoqërimin me kafshët e të njëjtit lloj.

- Të përcaktojë vendin për grumbullimin e mbeturinave.
- Të kujdeset për higjienën e kafshëve dhe t'u sigurojë një zonë të lëvizjes së lirë.
- Të kontrollojë funksionimin e pajisjet mekanike, dhe automatike kryesore.
- Të identifikojë defektet e mosfunksionimit normal të paisjeve.
- Të komunikojë me etikë e profesionizëm.
- Të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë akomodimit të përshtatshëm lidhur me mirëqënien e kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje dhe përgjigje me gojë.

RM 2 Nxënësi kryen të ushqyerit e kafshëve lidhur me mirëqënien e tyre.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve.
- Të përcaktojë radhën e duhur të punës për të ushqyerin e kafshës
- Të përzgjedhë llojin e ushqimeve sipas llojit, peshës e nevojave të kafshës.
- Të kontrollojë rregullisht peshën dhe të përcaktojë llojin e ushqimit shtesë, nëpërmjet balancimit të nevojave të kafshëve.
- Të plotësojë nevojat e kafshëve me ushqime shtesë në rastet e një ushqimi të pamjaftueshëm.
- Të kontrollojë koritat, pirëset automatike dhe rezervuarët e ujit.
- Të kontrollojë cilësinë e ushqimeve gjatë procesit të të ushqyerit të kafshës.
- Të organizojë të ushqyerit për konsumim të barabartë ushqimi.
- Të sigurojë furnizimin me ujë në sasi e cilësi në çdo kohë ose sipas programeve të parapërgatitura.
- Të komunikojë me etikë e profesionizëm.
- Të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të përshtatshëm lidhur me mirëqënien e kafshëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje dhe përgjigje me gojë.

RM 3	Nxënësi kujdeset për shëndetin fizik e mendor të kafshës në harmoni me mjedisin.
-------------	---

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë uniformën e punës për shërbimet që do kryejë.
- Të kontrollojë gjendjen shëndetësore të përgjithshme të kafshëve, të paktën njëherë në ditë.
- Të identifikojë sjelljet e kafshëve dhe shenjat kryesore në këto sjellje si: sjellje seksuale, të mbrojtjes, të ikjes, sjelljes në situata stresuese.
- Të zbatojë kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqënies së kafshëve për mbarështimin, prodhimin, përdorimin, shitjen, therjen, eliminimin sipas llojeve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve.
- Të zbatojë gjithë masat për parandalimin e luftimeve midis kafshëve.
- Të lejojë trajtimin profilaktik të rregullt dhe ndërhyrjet mjekësore gjatë sëmundjeve apo dëmtimeve.
- Të kryejë vizitat te mjeku veterinar me pasaportën mjekësore duke shënuar vaksinimet dhe mjekimet.
- Të lejojë ndërhyrjet që shkaktojnë dhimbje dhe vuajtje vetëm me anestezi nga mjeku veterinar.
- Të sigurojë lëvizjen ditore gjatë mbarështimit në mjedise të mbyllura.
- Të kryejë transportin e kafshëve me mjete transporti, në kushtet e mirëqënies së kafshëve.
- Të komunikojë me etikë e profesionizëm.
- Të zbatojë masat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesjes për shëndetin fizik dhe mendor të kafshës në harmoni me mjedisin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje dhe përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit	<ul style="list-style-type: none"> – Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës. – Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë kafshë në rregjim stallor. – Mësuesi/instruktori duhet të demonstrojë veprimtari konkrete pune për shërbime kujdesi për kafshë. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për shërbime kujdesi që lidhen në mirëqënien e kafshëve në fillim në mënyrë të mbikqyrur e pastaj në mënyrë të pavarur. – Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryhen gjatë akomodimit, të ushqyerit të kafshëve dhe kujdesit për shëndetin fizik e mendor të kafshëve. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për realizimin e proceseve të punës për shërbime kujdesi që lidhen me mirëqënien e kafshëve. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
--	---

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Baza prodhuese e shkollës ose fermë ku rriten kafshë. – Pajisje dhe vegla pune për shërbimet ndaj kafshëve, lopata, cfurçe, karroca dore, kova uji, makineri e pajisje për largimin e plehut. – Korita, lugje uji, pirëse automatike. – Ushqime të ndryshme sipas llojit dhe nevojave të kafshëve, katalogje ushqimesh. – Tabela me nevojat ushqimore të kafshëve. – Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve për mjeljen mekanike, pajisje për pastrimin e kafshës. – Mjete ndihmëse vizuale.
---	---

2. Moduli: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i mjediseve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	DEZINFEKTIMI, DEZINSEKTIMI DHE DERATIZIMI I MJEDISEVE.	M-28-1556-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit për kryer procese pune për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe mjedisit, për mënyrat e dezinfektimit, për zhdukjen e insekteve dhe brejtësve në fermën blegtorale.	
Kohëzgjatja e modulit	81 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen dezinfektimin e stallave dhe mjediseve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të përdorë patjetër veshjet mbrojtëse gjatë punës.– Të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës për dezinfektim.– Të përzgjedhë saktë llojet e dezinfektantëve sipas udhëzimeve të dhëna.– Të kryejë me shumë kujdes transportimin e materialeve, veglave të punës dhe dezinfektantëve në vendin e duhur.– Të nxjerrë kafshët në kullotë.– Të largojë mbeturinat dhe pastrojë mjedisin sipas parametrave të kërkuara higjienike në plehërishte.– Të largojë nga stalla plehun organik me mjete si lopata, cfurqe, karroca dore etj..– Të largojë plehun me pajisje të plehut, pranë stallave.– Të përdorë gropat e plehut dhe urinës për të pakësuar ndotjen ekologjike në mjedis.– Të trajtojë në gropat e plehut dhe urinës, me dekompozim plehun organik, sipas kushteve të fermës– Të lajë me ujë të bollshëm dhe fërkim dyshemetë, muret, dyert, grazhdet, koritat e ujit etj.– Të kryejë dezinfektimin e stallës me sherbet gëlqere\pluhur gëlqere etj.– Të spërkasë ose të pluhurosë me kujdes stallën dhe	

territorin përreth.

- Të shtrojë, pas dezinfektimit në stallat me çimento, shtresë të re me tallash\kashtë, për kafshët.
- Të kryejë larjen dhe pastrimin e gropave të dezinfektimit.
- Të përgatisë tretësirën për gropat e dezinfektimit.
- Të kontrollojë lëvizjen e kafshëve dhe njerëzve në gropat e dezinfektimit.
- Të dezinfektojë me shumë kujdes pajisjet si: pompat spërkatëse e pluhurosëse, lopatat etj.
- Të pastrojë veglat dhe pajisjet pas punës.
- Të kryejë pastrimin vetjak pas punës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së mjeteve të punës për dezinfektimin e stallave dhe territorëve të fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen dezinfektimin e stallave dhe të mjediseve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përcaktojë saktë llojet e insekteve që do të luftohen.
- Të përcaktojë mënyrën e duhur të dezinfektimit.
- Të zgjedhë saktë llojin e dezinfektantit që do të përdorë.
- Të përzgjedhë saktë pajisjet dhe mjetet e punës për dezinfektim.
- Të përcaktojë saktë veshjet mbrojtëse që do të përdorë gjatë punës.
- Të kryejë me shumë kujdes transportimin e materialeve, veglave të punës dhe desinsektantëve në vendin e punës.
- Të përgatitë pajisjet për dezinfektim, si pompa spërkatëse, pluhurosëse, lopata etj, sipas rregullave teknike.
- Të përcaktojë dozën dhe sasinë dezinfektantit, sipas llojit të insektit dhe shkallës së përhapjes së tij.
- Të përgatisë tretësirën dezinfektuese sipas procedurës përkatëse.
- Të kryejë, me shumë kujdes, trajtimin kimik me spërkatje ose plurosje, në mjediset e brendshme dhe të jashtme.
- Të përdorë insekticidet në formën e tretësirës së gatshme, sipas rregullit.
- Të përdorë insekticidet tërheqëse (joshëse) në mjediset e mbyllura si: baxho, magazina, etj, në sasinë e duhur.
- Të përdorë insekticidet në trupin e kafshëve, sipas kriterëve të përcaktuara.
- Të kryejë siç duhet, pastrimin e veglave, pajisjeve, pas punës.

- Të kryejë pastrimin e trupit të tij pas punës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së dezinfektimit me vendosjen e tabelave njoftuese, etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen deratizimin e stallave dhe të mjediseve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përcaktojë saktë llojet e brejtësve që do të luftohen.
- Të përcaktojë mënyrën më të përshtatshme të deratizimit.
- Të zgjedhë saktë llojin e deratizantit që do të përdorë.
- Të përzgjedhë siç duhet pajisjet dhe mjetet e punës për deratizim.
- Të përcaktojë saktë veshjet mbrojtëse që do të përdorë gjatë punës.
- Të kryejë me shumë kujdes transportimin e materialeve, veglave të punës dhe deratizantëve në vendin e punës.
- Të përgatisë pajisjet për deratizim, si pompa spërkatëse, pluhurosëse, lopata etj, sipas rregullave përkatëse.
- Të përcaktojë saktë dozën dhe sasinë e deratizantit.
- Të përgatisë sipas procedurës teknike tretësirën deratizuese.
- Të kryejë sipas rregullit trajtimin kimik me spërkatje ose pluhurosje, në mjediset e brendshme dhe të jashtme.
- Të përdorë siç duhet preparatet tërheqëse (joshëse, kurthe) në ambjentet e mbyllura si: baxho, magazina, etj.
- Të përdorë mjetet mekanike për luftimin e brejtësve, si: çarqe etj.
- Të kryejë pastrimin e veglave dhe pajisjeve pas punës.
- Të kryejë pastrimin e trupit të tij pas punës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë me rreptësi masat e sigurimit teknik gjatë punës dhe të sigurimit të territorit pas kryerjes së deratizimit me vendosjen e tabelave njoftuese, etj..

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin enxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikën profesionale të shkollës dhe në stalla pranë shkollës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe të mjediseve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe të

mjediseve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.

- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me mënyrat e dezinfektimit, dezinfektimit dhe të deratizimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe të mjediseve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen stalla, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë dhe ambiente për rritjen e kafshëve dhe kafshë të ndryshme.
 - Pompa spërkatëse, pluhurose, lopata etj., insekticide të gatshme.
 - Preparate dhe insekticide tërheqëse, çarqe minjsh, peshqirë, pece, kova uji.
 - Lopata, cfurqe, gërryese, furça, karrocë dorë etj.
 - Komplete veshje pune për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim.
 - Dezinfektant, dezinfektant dhe deratizant kimik
 - Mjete të tjera vizuale, video me demonstrime të ndryshme.
-

3. Moduli: “Shërbime kujdesi për riprodhimin e kafshëve të fermës”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhen kod	SHËRBIME KUJDESI PËR RIPODHIMIN E KAFSHËVE TË FERMËS	M-28-1557-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për t'u kujdesur për gjendjen në tufë për çiftëzim, për të vrojtuar afshin në lopë dhe dele, të kujdeset për kafshën barse, si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet që i kryhen kafshës gjatë trajtimit për riprodhim.	
Kohëzgjatja e modulit	81 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kujdeset për çiftëzimin në tufë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë siç duhet dhe të veshë patjetër uniformën;– të përzgjedhë kafshët që do të çiftëzohen në tufë (lopë, dele, dosa etj.);– të përcaktojë saktë shenjat e afshit sipas llojit të kafshës;– të deklarojë saktë frekuencën dhe kohëzgjatjen e gjendjes së afshit për lloje të ndryshme kafshësh;– të kujdeset për tufën gjatë procesit të çiftëzimit;– të përcaktojë vendin me hapësirat e nevojshme për çiftëzimin në tufë– të përzgjedhë damazin, si: dem, dash, harç etj, për çiftëzim, sipas vlerave racore;– të përcaktojë moshën dhe peshën për kafshët që do të futen në ndërzim për herë të parë;– të përzgjedhë metodën e çiftëzimit, ndërzimin natyror\ inseminimin artificial të kafshëve në tufë si: në dele, lopë, dosa etj;– të zbatojë saktë kriteret që nevojiten për çiftëzimin e kafshëve;– të kontrollojë ecurinë e procesit të çiftëzimit në tufë;– të vrojttojë sjelljen riprodhuese të kafshëve në procesin e çiftëzimit– të mbajë saktë shënimet përkatëse gjatë procesit të çiftëzimit në tufë;	

-
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë çiftëzimit të kafshëve tufë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi vrojton shenjat e afshit në lopë dhe dele.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përcaktojë siç duhet planin e punës për zbulimin e shenjave të afshit te lopët/delet.
- Të identifikojë lopët/delet në afsh për vrojtim.
- Të vrojtojë me kujdes shenjat e afshit në stallë, padok\kullotë, 5 herë në ditë.
- Të identifikojë lopët me shenjat e afshit si: ulje oreksi, pëllitje të shpeshta, lëvizje të shumta, shikim të përqendruar, ënjtje dhe skuqje e vulvës, rrjedhje mukusi, ngrihte bishti, pranimit i kërcimit të një lope tjetër etj.
- Të vrojtojë afshin në dele, në vatha\kullota të gjera.
- Të organizojë zbulimin e afshit në dele 2 herë në ditë.
- Të përcaktojë hapësirat e vathës, sipas madhësisë së tufës së dhurve.
- Të lëshojë një dash prove, me përparëse, për zbulimin e afshit në çdo 50 krerë dele.
- Të identifikojë delet me shenja afshi, si: gjatë kërcimit të dashit nuk largohen, qëndrojnë të qeta, presin të ndërrehen etj.
- Të mbahen saktë shënimet për çdo vrojtim.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kontrollit të lopëve dhe deleve në afsh.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kujdeset për tufën gjatë mbarsmërisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë ambientin për mbajtjen e kafshëve barse në periudha të ndryshme të mbarsmërisë;
- të përcaktojë kohëzgjatjen e mbarsmërisë në kafshët e ndryshme të tufës;
- të trajtojë kafshën barse në periudha të ndryshme, si: laktacion, tharje deri në pjellje;
- të zbatojë masat veterinarë dhe higjienike në kafshët barse;
- të ushqejë kafshët barse në periudha të ndryshme të mbarsmërisë me racione të caktuara ushqimore;
- të kryejë lëvizjen e kafshëve barse në stalla të veçanta, sipas gjëndjes fiziologjike;

- të kontrollojë gjendjen e kafshëve në muajin e fundit të mbarsmërisë;
- të bëjë rregjistrimin e operacioneve të punës të kryera në stallë;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë saktë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në stalla gjatë periudhës së mbarsmërisë në kafshët barse;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet që kryhen gjatë trajtimit të tufës për riprodhim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të llogaritë kostot në trajtimin e kafshës në riprodhim, si dhe përbërësit e kostove.
- të bëjë preventivin e materialeve, koston për materialet.
- të llogaritë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- të komunikojë me etikë e profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të riprodhimit të tufës..

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ose në ferma blegtorale me lopë, dele apo derra.
- Instruktori mund të organizojë vizita mësimorë në komplekse blegtorale duke i'u dhënë mundësi nxënësve për të vërtetuar konkretisht disa nga shenjat në kafshë të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për t'u kujdesur për tufën gjatë çiftëzimit, për të kryer vërtetime për zbulimin dhe përcaktimin e shenjave të afshit të kafshët dhe për t'u kujdesur për kafshën barse, vetëm në mbikqyrje të instruktorit apo specialistit veterinar, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve riprodhuese në ferma blegtorale.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me çiftëzimet në tufë, shenjat e afshit të kafshët dhe kujdesin për kafshën barse, llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve riprodhuese në ferma blegtorale e kafshëve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e përcaktimit të shenjave të afshit në kafshë të ndryshme.

-
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese ose fermë blegtorale.
 - Kafshë në afsh, kafshë barse.
 - Deshë të provës.
 - Harça të provës.
 - Dokumentacion për mbajtjen e shënimeve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Vidio me demonstrime të ndryshme.
 - Kartela.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e blegtorisë (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

4. Moduli: “Kujdesi për kafshën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurit”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhen kodit	KUJDESI PËR KAFSHËN GJATË PJELLJES DHE PËR TË PORSALINDURIN	M-28-1558-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për t'u kujdesur për lopën në prag të pjelljes, të ndihmojë kafshën gjatë pjelljes dhe të porsalindurin, të kujdeset për kafshën pas pjelljes, si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet që kryhen gjatë trajtimit të lopëve gjatë pjelljes.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kujdeset për lopën në prag të pjelljes. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë siç duhet dhe të veshë patjetër uniformën: bluzë, kapuç, dorëza;– të sigurojë mjetet e nevojshme të punës si: kovë, ujë, sapun, litarë, dezinfektant, pambuk, peshqirë etj.;– të përcaktojë ambjentin e pjelljes (në maternitet) sipas kriterëve të duhura: vend i qetë, pa lëvizje, i pastër, i ajrosur, i ngrohtë;– të sigurojë ndalimin e lëvizjes së lirë të njerëzve në maternitet;– të ndalojë futjen e mjeteve mekanike në maternitet, duke shmangur zhurmat;– të përgatisë sipas parametrave të duhura vendin e pjelljes;– të kryejë pastrimin, dezinfektimin dhe vendosjen e shtresës së bollshme në vendin e pjelljes;– të përgatisë siç duhet kafshën për pjellje: larje e pjesëve të pasme të trupit me ujë të ngrohtë e sapun, lyerje e organeve gjinorë të jashtme me dezinfektantë;– të regjistrojë të dhënat e duhura të çdo lope në kartelën përkatëse;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes të	

mjedisit gjatë kujdesit për lopën në prag të pjelljes; .

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi ndihmon kafshën gjatë pjelljes dhe të porsalindurin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndjekë me vëmendje fazat e procesit të pjelljes: fazën përgatitorë dhe të nxjerrjes së frytit.
- të qëndrojë pranë specialistit për ta ndihmuar atë në tërheqjen e frytit: gjymtyrët e para ose të pasme tërhiqen në momentin e shtërëzimit.
- të ndihmojë specialistin veterinar në lidhjen e kërthizës 8-10 cm larg nga lëkura e barkut te i porsalinduri.
- të ndihmojë specialistin veterinar në këputjen/prerjen 2-3 cm larg vëndit të lidhjes te i porsalinduri.
- të ndihmojë specialistin veterinar në dezinfektimin e kërthizës te i porsalinduri.
- të kontrollojë nxjerrjen e placentës te kafsha pas pjelljes.
- të pastrojë mjedisin duke e pudrosur me pluhur gëlqereje dhe duke shtruar shtresë të thatë.
- të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pjelljes së kafshës..

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kujdeset për kafshën pas pjelljes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë pastrimin dhe dezinfektimin e vendqëndrimit të kafshës pas pjelljes.
- të japë ujë të ngrohtë menjëherë pas lëpirjes së të porsalindurit: ujë të ngrohtë 37-38 °C + kripë gjelle.
- të përcaktojë mënyrën e të ushqyerit të kafshës së sapa pjellë, sipas gjendjes shëndetësorë.
- të vendosë në lëvizje 1-2 orë në ditë kafshën.
- të zbatojë rregullat e mjeljes së lopëve 4-5 herë në ditë.
- të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit pas pjelljes së kafshës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje - përgjigje.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet që kryhen për kafshën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurinjellje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të llogaritë kostot e shërbimeve të kujdesit për kafshën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurin, si dhe përbërësit e kostove.
- të bëjë preventivin e materialeve, koston për materialet.
- të llogaritë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh etj.).
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të kujdesit për kafshën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurin

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ose në ferma blegtorale me lopë, dele apo derra. Instruktori mund të organizojë vizita mësimorë në komplekse blegtorale duke iu dhënë mundësi nxënësve për të vrojtuar konkretisht kafshën në prag të pjelljes, ndihma për kafshën gjatë pjelljes dhe të porsalindurin, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve riprodhuese, pranë shkollës ose në ferma blegtorale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për të kryer vrojttime për zbulimin dhe përcaktimin e shenjave të pjelljes të kafshët, vetëm në mbikqyrje të instruktorit apo specialistit veterinar.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me shenjat e pjelljes, ndihmën për kafshën gjatë pjelljes dhe të porsalindurin.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e përcaktimit të shenjave të pjelljes, ndihmën gjatë pjelljes dhe të porsalindurin, në kafshë të ndryshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese ose fermë blegtorale.
 - Kafshë barse.
 - Dokumentacion për mbajtjen e shënimeve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
 - Kartela.
-

-
- Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e blegtorisë (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

5. Moduli: “Zbatimi i profilaksisë së përgjithshme në kafshët e fermës”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	ZBATIMI I PROFILAKSISË SË PËRGJITHSHME NË KAFSHËT E FERMËS	M-28-1559-19
-----------------	---	---------------------

Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të vënë në zbatim planin profilaktik, duke kryer izolimin e kafshëve të sëmura në fermë, përpunimin biotermik të plehut, asgjësimin e kafshëve të ngordhura, me groposje dhe me djegie, për të parandaluar përhapjen e sëmundjes në kafshët e fermës.
Kohëzgjatja e modulit	81 orë mësimorë
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen izolimin e kafshëve të sëmura në fermë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve.– Të identifikojë kafshën e sëmurë.– Të sigurojë hapësirën e caktuar e të veçuar në përputhje me nevojat e kafshës.– Të marrin masa për bllokimin e vatrës infektive duke mos lejuar hyrje, daljet e panevojshme, prodhimet blegtorale të kafshëve të sëmura. Të rregjistrohen kafshët e sëmura në rregjistër.– Të caktohen persona të veçantë për t'u kujdesur për kafshët e sëmura.– Të përzgjidhen mjete dhe orë të veçanta për kujdesin ndaj kafshëve të sëmura.– Të kujdesen për përhijjen dhe të ushqyerin e kafshëve të sëmura dhe të sigurohet një zonë të lëvizjes së lirë.– Të sigurohet trajtimi mjekësor nga mjeku veterinar.– Të mbahet kafsha e izoluar deri sa të shërohet.– Të komunikojnë me etikë e profesionizëm.– Të zbatojnë masat të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë izolimit të kafshëve të sëmura në fermë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.

-
- Pyetje dhe përgjigje me gojë.

RM 2 Nxënësi kryen përpunimin biotermik të plehut.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë kompletin e punës: kominoshe, përparëse bezeje, përparëse plasmasi, kapuç, dorashka llastiku, çizme, maskë hunde etj.
- Të përzgjedhë dhe përgatisë mjetet dhe pajisjet që përdoren për proceset e punës si: lopata, cfurqe, mjete motorike etj.
- Të përzgjedhë vende të izoluara për përpunimin e plehut, larg stallave, burimeve të ujit, kavaletave të barit etj.
- Të hapë gropën me thellësi 25 cm, gjerësi 2-3 m dhe gjatësi sipas sasisë së plehut që përpumohet.
- Të kryejë operacione pune në gropën e përpunimit biotermik si: hapja e kanalit me gjerësi e thellësi 20-30 cm.
- Të kryejë mbushjen e kanaleve me shkurre e ferra për qarkullimin e ajrit.
- Të kryejë hedhjen shtresë pas shtrese të plehut të thatë.
- Të kryejë pluhurosjen me gëlqere të pashuar të plehut
- Të kryejë ndërtimin e kavaletës me plehun e kafshëve të sëmura deri në 2 m lartësi.
- Të mbulojë kavaletën me një shtresë dheu prej 30 cm.
- Të kryejë herë pas here dezinfektimin e kavaletës së plehut me heksakloran\lindan.
- Të kryejë djegien e plehut me spore të mikrobeve si plasje, këmbëzezë etj, sipas porosisë së mjekut veterinar.
- Të hapë gropën e përpunimit biotermik të plehut pas 3 javë-3 muaj.
- Të mbajë saktë shënimet për operacionet e punës.
- Të kryejë pastrimin, larjen dhe dezinfektimin e mjeteve të punës.
- Të zbatojë masat për higjienën personale për të mënjanuar infeksionet në njerëz e kafshë.
- Të komunikojë me etikë profesionale
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit biotermik të plehut

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 3 Nxënësi asgjeson kafshë të ngordhura me groposje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë dhe përgatitë siç duhet, veglat, materialet, si dhe uniformën të domosdoshme për kryerjen e asgjesimit të kafshës me groposje.
- Të përcaktojë vendin për asgjesimin e kufomës me groposje,

sipas kriterere të duhura.

- Të hapë gropën për asgjësimin e kufomës sipas rregullit të caktuar.
- Të vendosë kufomën në gropë sipas rregullit të duhur.
- Të mbulojë kufomën me dhë.
- Të komunikojë me etikë profesionale.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për asgjësimin me groposje të kafshëve të ngordhura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi asgjëson kafshë të ngordhura me djegie.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë dhe përgatitë veglat, materialet, si dhe uniformën të domosdoshme për kryerjen e asgjësimit të kafshës me djegie.
- Të përcaktojë vendin për asgjësimin e kufomës me djegie, sipas kriterere të duhura.
- Të hapë gropën për djegien e kufomës sipas rregullit të caktuar.
- Të vendosë siç duhet, kufomën në gropë.
- Të kryejë lyerjen e trupit të kafshës së ngordhur me lëndë djegëse, me shumë kujdes.
- Të realizojë djegjen e kufomës sipas rregullit të caktuar.
- Të bëjë siç duhet, mbulimin e kufomës më dhë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për asgjësimin e kafshëve të ngordhura me djegie.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul mund të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës ose në territorët jashtë saj.
- Mësuesi instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimorë në vorrezat e kafshëve, ku mund të shohin praktikisht se si bëhet groposja e kafshëve të ndryshme.
- Nxënësit duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e kryerjes së groposjes së kafshëve. Kjo duhet të përfshijë përgatitjen e mjeteve dhe uniformës, kryerjen e izolimit, si dhe për asgjësimin e kafshëve.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet praktike për përgatitjen e mjeteve dhe uniformës, për groposjen e trupit të kafshëve.
- Realizimi i pranuehëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese e shkollës.
 - Kafshë të ndryshme.
 - Lëndë djegëse.
 - Vegla të thjeshta për hapjen e gropës, si: lopata, cfurqe, karroca dore etj..
 - Vegla për groposjen e kafshëve të ngordhura.
 - Mjete të thjeshta për fiksimin e kafshëve.
 - Dezinfektantë për duar dhe për territorin.
 - Komplet i veshjes.
 - Pompa spërkatëse dhe pluhurosëse.
 - Peshqir, kova uji, sapun.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Trajtimi i kafshëve për prodhim qumështi e mishi”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	TRAJTIMI I KAFSHËVE PËR PRODHIM QUMËSHTI E MISHI	M-28-555-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për trajtimin e kafshëve në periudhën e laktacionit dhe trajtimin e kafshëve për mish, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me trajtimin e kafshëve për prodhim qumështi e mishi.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi trajton lopët në periudhën e laktacionit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë uniformën për kryerjen e shërbimeve në stallë.– të përzgjedhë stalla me hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin dhe lëvizjen e lopëve.– të largojë në kohën e duhur plehun nga stalla.– të pastrojë dhe dezinfektojë vendqëndrimin e kafshës.– të sigurojë temperaturën dhe ajrimin normal të mjedisit në stallë.– të kryejë pastrimin e lëkurës së trupit të kafshës sipas teknikës përkatëse.– të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e trupit të lopëve– të realizojë pastrimin dhe ruajtjen e higjienës së trupit të lopëve.– të përzgjedhë mjetet e nevojshme për ushqyerjen e lopëve.– të përllogaritë sasinë e qumështit që do të prodhohet nga çdo llope në laktacion.– të përzgjedhë ushqimet për lopët në laktacion.	

-
- të hartojë dhe përgatitë racionin ushqimor, sipas fazave të laktacionit.
 - të bëjë ndarjen racionale e ushqimit për lopë.
 - të hedhë me kujdes ushqimin në grazhdë.
 - të përgatitë lopët për mjelje sipas kushteve higjiensanitare.
 - të realizojë mjeljen me dorë ose në mënyrë mekanike sipas mundësive.
 - të grumbullojë në enë të posaçme qumështit e mjelë.
 - të paketojë qumështin e grumbulluar për treg sipas kërkesës.
 - të ruajë në kushte të caktuara higjiensanitare qumështin e grumbulluar.
 - të regjistrojë të dhënat e duhura, në kartelën përkatëse, për çdo lopë.
 - të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet që përdoren për pastrimin e lopëve dhe ambientit të tyre.
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambientit gjatë trajtimit të lopëve në laktacion

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 2 Nxënësi trajton delet e dhitë gjatë periudhës së laktacionit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë uniformën dhe veglat e nevojshme të punës për trajtimin e deleve e dhive në laktacion.
- të përllogaritë sasinë e ushqimit kundrejt numrit të kafshëve që mbarështohen.
- të përcaktojë llojshmërinë e ushqimeve që do të përdoren për trajtimin e kafshëve në laktacion sipas nevojës së kafshës në regjimin stallor si: hasëlle, bar i thatë, gjethe dushku, silazh, koncentrat, etj.
- të përgatisë racionin ushqimor për dhentë e dhitë në laktacion sipas prodhimit të qumështit
- të ushqejë kafshët në stalla, sipas vakteve të caktuara.
- të përgatisë mjedisin për ushqyerjen e kafshëve në kullotje të lirë.
- të realizojë kullotjen e lire të deleve dhe dhive në periudhën e laktacionit.
- të kujdeset për qengjat dhe kecat gjatë pirjes së kulloshtrës dhe qumështit tek nënat, në sasinë dhe kohën e duhur.
- të shkëputë qengjat dhe kecat nga nënat, në kohën e duhur.
- të kontrollojë peshën trupore të qengjave e kecape dhe kohën e shkëputjes nga nëna.

- të kujdeset vazhdimisht për higjienën e gjirit në dele e dhi,si: pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit.
- të mjelë delet dhe dhitë sipas kohës së përcaktuar.
- të shënojë saktë sasisë e qumështit të mjelë, në kartelën përkatëse.
- të grumbullojë qumështin e mjelë në enë të posaçme.
- të paketojë qumështin për treg, sipas kërkesës.
- të ruajë qumështin në kushtet e duhura higjiono-sanitare.
- të regjistrojë saktë të dhënat në kartelën përkatëse.
- të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet e pajisjet që përdorën gjatë trajtimit të deleve e dhive në periudhën e laktacionit.
- të përcaktojë dhe përgatisë territorin e duhur për kullotjen e deleve ose dhive.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve dhe trajtimit të deleve e dhive. gjatë laktacionit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi trajton viçat për majmëri.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë e të veshë uniformën për trajtimin e viçave për majmëri.
- Të përzgjedhë ambientin e përshtatshëm për viçat e majmërisë
- Të përzgjedhë veglat dhe paisjet për kryerjen e shërbimeve në stallë.
- Të sigurojë mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar.
- Të sigurojë kushtet higjenike në stallë, sipas standardit të kërkuar.
- Të përzgjedhë viçat për majmëri, sipas kriterëve të duhura.
- Të përzgjedhë veglat e duhura për ushqyerjen e viçave.
- Të përllogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të viçave për majmëri.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e viçave për majmëri.
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave.
- Të bëjë ndarjen racionale të ushqimit kokë për kokë.
- Të kryejë hedhjen e ushqimit në grazhd.
- Të sigurojë sasinë e ujin të pijshëm të nevojshëm për viçat në majmëri.
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për sejcilin viç.

- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë drejtë masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e viçave për majmëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 4 Nxënësi trajton derrat për majmëri.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë e të veshë uniformën për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të përzgjedhë ambjentin e përshtatshëm për derrat e majmërisë
- Të përzgjedhë veglat dhe paisjet për kryerjen e shëbimeve në stallë.
- Të sigurojë kushtet higjenike dhe mikroklimën në stallë sipas standardit të kërkuar.
- Të përzgjedhë derrat për majmëri, sipas kriterëve të duhura.
- Të përzgjedhë veglat e duhura për ushqyerjen e derrave.
- Të përlllogarisë sasinë e ushqimeve për numrin e caktuar të derrave për majmëri.
- Të përzgjedhë saktë llojet e ushqimeve për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të përlllogarisë sasinë e nevojshme të ushqimeve për trajtimin e derrave për majmëri.
- Të hartojë racionin ushqimor sipas grup moshave.
- Të bëjë ndarjen racionale të ushqimit kokë për kokë.
- Të sigurojë sasinë e ujin të doemosdoshëm të pishëm për derrat në majmëri.
- Të regjistrojë të dhënat e duhura në kartelën përkatëse për sejcilin derr.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë drejtë masat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për trajtimin e derrave për majmëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të trajtimit të kafshëve për prodhin qumështi e mishi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot në trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit, si dhe përbërësit e kostove, sipas manualit

përkatës.

- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport, amortizime dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit..

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë lopë, dele e dhi me regjim stallor dhe kullosor dhe që janë në periudhën e laktacionit, në rastet e trajtimit të kafshëve për mish (viça e derra), si dhe për llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punëve që kryhen për trajtimin e të kafshëve gjatë periudhës së laktacionit dhe trajtimit të kafshëve për mish në bazën prodhuese të shkollës dhe ekonomi blegtorale, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me metodat e trajtimit të kafshëve në laktacion e majmëri.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në fermën e shkollës dhe ambiente të tjera të përshtatshme për trajtimin e kafshëve në periudha të ndryshme të laktacionit e të majmërisë, llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me trajtimin e kafshëve të qumështit dhe mishit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për trajtimin e kafshëve të qumështit dhe të majmërisë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese ose fermë për rritjen e kafshëve.
- Pajisje dhe vegla pune për pastrimin e stallës dhe trupit të kafshëve.
- Furça, sfungjerë, kashai, thika druri.
- Peshqirë, pece, kova uji për higjienën e gjirit.

-
- Aparat për mjelje mekanike.
 - Bidonë apo tank ftohës për ruajtjen e qumështit.
 - Tokë kullosore, magazinë ushqimi, depo silazhi.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Tabela për nevojat ushqimore të kafshëve.
 - Mjete të tjera vizuale, materiale studimore.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
 - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore.
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e blegtorisë (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal
-

2. Moduli: “Kujdesi për kafshët e shoqërimit dhe shpendët dekorativë”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KUJDESI PËR KAFSHËT E SHOQËRIMIT DHE SHPENDËT DEKORATIVË	M-28-1560-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për t'u kujdesur për mbarështimin dhe ushqyerjen e shpendëve dekorativ, si dhe për kujdesin për rritjen dhe ushqyerjen e kafshëve të shoqërimit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi kujdeset për mbarështimin dhe ushqyerjen e shpendëve dekorativë. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet: I- Për kujdesin ndaj pëllumbave: <ul style="list-style-type: none">– Të përgatisë veshjen për punë.– Të kryejë shërbimet për ndërtimin e kafazit të pëllumbave.– Të përcaktojë ambjentin e vendosjes së kafazit në papafingo, oborr etj.– Të ndërtojë kafazin për çiftin e pëllumbave sipas standardit.– Të përzgjedhë racën e pëllumbave që do të mbarështojë.– Të mbikqyrë çiftëzimin e pëllumbave në periudha të caktuara të vitit.– Të kontrollojë procesin e pjelljes së vezëve, 5-6 pjellje në vit.– Të kujdeset për rritjen e zogjve të sapoçelur të pëllumbave.– Të kryejë shërbime klimatike në kafaz si: sigurimi i dritës natyrale, i ajrimit, i temperaturës, në papafingo.– Të vendosë në kafaz tasa balte me kashtë, me pluhur dezinfektues për morrat, pleshtat, etj.– Të rendisë sipas radhës së veprimeve operacionet e punës që kryhen në kafazin e pëllumbave.– Të përzgjedhë mjetet që nevojiten për pastrimin e kafazit.– Të pastrojë kafazin nga jashtëqitjet e pëllumbave dhe

mbeturinat ushqimore.

- Të zbatojë masat profilaktike duke përdorur vaksinat si tek shpendët.
- Të zbatojë rregullat e higjienës gjatë ushqyerjes së pëllumbave .
- Të përcaktojë enët e ushqimit dhe ujit për pëllumbat.
- Të përzgjedhë llojet e ushqimeve që konsumojnë më mirë.
- Të përzgjedhë ushqime të gatëshme me lëndët e nevojshme në dyqanet e shpendëve.
- Të përzgjedhë ushqime të njoma në çdo kohë si: fletë sallate, bar të njomë, etj
- Të përdorë në racionin ushqimor, ushqime si: misër, bizele, grurë, oriz, luledielli, etj.
- Të hedhë në ujin e pijshëm vitamina, 3 ditë në javë .
- Të vendosë në kafaz enë me tulla të thyera, zhavorr, qymyr druri, kripë, etj., për të plotësuar nevojat me lëndë minerale.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit në punë gjatë mbarështimit të pëllumbave.
- Të mbajë evidencat dhe shënimet përkatëse për veprimtaritë e kryera gjatë rritjes dhe ushqyerjes së pëllumbave.

II- Për kujdesin ndaj papagajtë.

- Të përcaktojë radhën e punës për ndërtimin e kafazit të papagajve.
- Të zgjedhë në pikat e shitjes së shpendëve dekorativë kafazë të gatshëm.
- Të përzgjedhë kafazin sipas numrit të papagajve që mbarështon.
- Të vendosë në kafaz shufra druri për të qëndruar papagalli.
- Të vendosë nga jashtë kafazit enët e ujit me tub, për të mos krijuar ndotje.
- Të përcaktojë periudhën e çiftëzimit të papagajve (shtator-dhjetor).
- Të përcaktojë moshën për riprodhim të papagajve femra (1 vjeç).
- Të vrojtojë procesin e çiftëzimit në papagajë.
- Të përcaktojë periudhën e inkubimit të vezëve.
- Të trajtojë zogjtë e papagajve në inkubator.
- Të përzgjedhë teknikat e të ushqyerit të papagajve.
- Të ushqejë të vegjlit në inkubator me shiringë nga goja
- Të ushqejë papagajtë në kafaz me fruta dhe perime të freskëta.
- Të përzgjedhë në racionin ushqimor fruta si: rrush mollë, pjeshkë etj,
- Të përzgjedhë për ushqim sallatë jeshile, patate, oriz,

krunde me bukë, etj.

- Të përdorë vitaminat pluhur me ushqime të buta disa herë në javë.
- Të shtojë në racionin ushqimor bllok mineral, pluhur Ca në periudhën e shtimit me vezë.
- Të zgjedhë në dyqanet e shpendëve dekorativë ushqime të gatshme me vlera të larta ushqyese.
- Të zbatojë masat profilaktike duke kryer vaksinimet dhe mjekimin në momentin e duhur.
- Të kryejë pastrimin e kafazit të papagajve nga jashtëqitjet dhe mbeturinat ushqimore.
- Të përzgjedhë mjetet për pastrimin e enëve të ushqimit, ujit dhe kafazit të papagajve
- Të mbajë saktë shënimet përkatëse për punën e kryer.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurimit teknik në punë gjatë rritjes dhe ushqyerjes së pëllumbave dhe papagajve..

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kujdeset për rritjen dhe ushqyerjen e kafshëve të shoqërimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet:

I - Për kujdesin ndaj qenve:

- Të përgatisë veshjen për punë.
- Të përzgjedhë racën e qenve, të pastërta/të kryqëzuara.
- Të zgjedhë qenin sipas moshës, këlysh/të rritur.
- Të zgjedhë qenin sipas seksit.
- Të zgjedhë qenin sipas gjatësisë së qimes.
- Të përzgjedhë ambientin ku do të vendoset qeni për fjetje dhe ushqim.
- Të përdorë mjetet ndihmëse sipas nevojave të kafshës (qafore për parazitët, rryp, zinxhir, hundëse, krëhër, shampo, etj).
- Të kryejë pastrimin e trupit të qenit me krëhër/furçë.
- Të kryejë larjen e trupit të qenit me ujë të ngrohtë dhe shampo të posaçme.
- Të kryejë qethjen e qenve leshator.
- Të kryejë pastrimin i syve, veshëve dhe dhëmbëve të qenit.
- Të kryejë prerjen e thonjve, bishtit dhe veshëve tek mjeku veteriner.
- Të përcaktojë periudhën e shumëzimit tek qentë.
- Të përzgjedhë ushqime të pasura me vitamina dhe kalçium gjatë mbarsmërisë

- Të kujdeset për këlyshët e porsalindur.
- Të kujdeset për konet gjatë procesit të rritjes.
- Të përzgjedhë llojin e ushqimit për qentë.
- Të përdorë ushqime proteinike në racionin ushqimor si: mish, peshk, bulmet dhe vezë.
- Të përdorë drithëra dhe perime në racionin ushqimor.
- Të përdorë ushqime të gatëshme me gjithë lëndët e nevojshme.
- Të përzgjedhë enët e ushqimit.
- Të përdorë lëndë minerale dhe vitamina në ushqim në formë biskotash.
- Të kujdeset për edukimin dhe trajnimin e qenit me metoda ushtrimore.
- Të kontrollojë qenin për parazitë.
- Të zbatojë masat profilaktike (skemën e vaksinimit) dhe mjekuese në qen.
- Të zbatojë masat e sigurimit teknik, të higjienës personale dhe të ruajtjes së ambjentit, gjatë punës për rritjen dhe ushqyerjen e qenve.
- Të mbajë evidencat dhe regjistrimet përkatëse të operacioneve që kryhen.

II - Për kujdesin ndaj maceve:

- Të përzgjedhë racën e maceve, të pastërta/të kryqëzuara.
- Të zgjedhë macen sipas moshës, kotele/të rritur.
- Të zgjedhë macen sipas seksit.
- Të zgjedhë macen sipas gjatësisë së qimes.
- Të përzgjedhë ambjentin ku do të qëndrojë macja për fjetje, ushqim dhe defekim.
- Të përdorë mjetet ndihmëse sipas nevojave të kafshës (qafore për parazitët, furçë të butë gome, krëhër metalik, shampo etj).
- Të kryejë pastrimin e trupit të maces me krëhër/furçë.
- Të kryejë larjen e trupit të maces me ujë të ngrohtë dhe shampo të posaçme.
- Të kryejë pastrimin i syve, veshëve dhe dhëmbëve të maces.
- Të përcaktojë periudhën e shumëzimit tek macet.
- Të përzgjedhë ushqime të pasura me vitamina dhe kalçium gjatë mbarsmërisë.
- Të kujdeset për kotelet e porsalindura.
- Të kujdeset për kotelet gjatë procesit të rritjes.
- Të përdorë ushqime proteinike në racionin ushqimor si: mish të trajtuar termikisht, mëlçi, peshk i konservuar pa hala, bulmet, djathë, vezë etj.
- Të përdorë ushqime të gatshme me gjithë lëndët e nevojshme.
- Të përzgjedhë enët e ushqimit, ku pjata e ushqimit nuk

- duhet të jetë plastike.
- Të përdorë lëndë minerale dhe vitamina në ushqim.
 - Të kujdeset për edukimin dhe trajnimin e maces me metoda ushtrimore.
 - Të kontrollojë macen për parazitë.
 - Të zbatojë masat profilaktike, skemën e vaksinimit dhe masat mjekuese në mace.
 - Të mbajë evidencat dhe regjistrimet përkatëse të operacioneve që kryhen.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
Të zbatojë masat e sigurimit teknik, të higjienës personale dhe të ruajtjes së ambjentit, gjatë punës për rritjen dhe ushqyerjen e qenve dhe maceve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin nxënësve.

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermës blegtorale në shkollë e jashtë saj, por rekomandohet të organizohen edhe vizita mësimore në klinika veterinare.

- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembuj dhe demonstrime konkrete të kujdesit ndaj kafshëve të shoqërimit dhe shpendëve dekorativ.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me çështje të kujdesit për shpendëve dekorativ dhe kafshëve të shoqërimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për modulin.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise dhe materialet e mëposhtme:

- Shpendë dekorativ.
 - Kafshë shoqërimi.
 - Ushqime për pëllumba dhe papagaj.
 - Ushqime për qen dhe mace.
 - Mjete, pajisje dhe solucione për ruajtjen e higjienës dhe pastërtisë.
 - Klasë e përshtatshme për zhvillimin e modulit.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Metodat e fiksimit të kafshëve”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Shërbime kujdesi për kafshë
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	METODAT E FIKSIMIT TË KAFSHËVE	M-28-1561-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të fiksuar kafshët e llojeve të ndryshme me metodat përkatëse, për qëllime shëndetsimi të thundrave, diagnostikimi dhe mjekimi.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi fikson gjedhin në stativ për shëndetin e thundrave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën si: bluzë e kapuç, çizme etj.– Të përzgjedhë kafshën për fiksimin në stativ.– Të vendosë në tavolinë makinën për thundrat e gjedhit, për lehtësimin e veprimeve pranë kafshës.– Të afrohet te kafsha me shumë kujdes, sipas rregullave.– Të bëjë futjen e lopës në stativ.– Të kryejë fiksimin e kokës në stativ, sipas udhëzimeve.– Të vendosë fashetat poshtë rajonit të barkut, sipas udhëzimeve.– Të bëjë fiksimin e këmbës së parë si në rastin e mbathjes.– Të bëjë fiksimin e këmbës së parë me litar.– Të bëjë fiksimin e këmbës së pasme si në mbathje.– Të bëjë fiksimin e këmbëve të pasme me litar.– Të përdorë makinën për trajtimin e thundrave.– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.– Të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për fiksimin e lopës në stativ për shëndetin e thundrave.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi fikson kalin në pozicionin në këmbë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën (bluzë e kapuç).
- Të përzgjedhë saktë mjetet që duhen për fiksimin e kalit në këmbë: javasha, litar etj.
- Të vendosë mjetet në tavolinë për lehtësimin e veprimeve pranë kafshës.
- Të afrohet te kafsha me shumë kujdes, sipas rregullave.
- Të bëjë fiksimin e veshit\buzës me javasha, sipas udhëzimeve.
- Të bëjë fiksimin e këmbës së parë si në rastin e mbathjes.
- Të bëjë fiksimin e këmbës së parë me litar.
- Të bëjë fiksimin e këmbës së pasme si në mbathje.
- Të bëjë fiksimin e dy këmbëve të pasme me litar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për fiksimin e kalit në pozicionin në këmbë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
-

RM 3 Nxënësi fikson gjedhin në pozicionin në këmbë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën.
- Të përzgjedhë mjetet e duhura për fiksimin e gjedhit në pozicionin në këmbë: javasha, unazat e hundës, litar etj
- Të vendosë mjetet pranë vendit ku do fiksohet kafsha.
- Të bëjë fiksimin e gjedhit nga brirët me duar
- Të bëjë fiksimin e gjedhit nga hundët me duar, javasha, unazë metalike.
- Të bëjë fiksimin e kokës duke lidhur brirët me litar të fortë pas një peme, shtylle a trangu.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë me rreptësi rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve

për fiksimin e gjedhit në pozicionin në këmbë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi fikson delen.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën: bluzë e kapuç.
- Të përcaktojë mjetet e duhura për fiksimin e deles, litar etj.
- Të afrojë me kujdes mjetet pranë vendit të fiksimit të deles.
- Të fiksojë delen duke e rrëzuar në shpinë dhe lidhur gjymtyrët 2 nga 2 me litarë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve për fiksimin e deles.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi fikson derrin në këmbë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe të veshë patjetër uniformën bluzë e kapuç.
- Të përcaktojë mjetet e fiksimit (litar).
- Të afrojë litarin pranë vendit të fiksimit.
- Të kalojë lakun në nofullën e sipërme.
- Të tërheqë litarin duke shtrënguar lakun.
- Të lidhë skajin e lirë të litarit në ndonjë shtyllë a pemë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë fiksimit të derrit..

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Nxënësi fikson kafshët e shoqërimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë kompletin e veshjes
- Të përcaktojë mënyrën e fiksimit të qenit dhe të maces.
- Të realizojë fiksimin e qenit sipas metodës së përcaktuar.

- Të realizojë fiksimin e maces sipas metodës së përcaktuar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik gjatë fiksimit të qenit dhe maces

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermës blegtorale në shkollë e jashtë saj, por rekomandohet të organizohen edhe vizita mësimore në klinika veterinare.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të fiksimit të kafshëve. Ato përfshijnë: fiksimin e kalit, gjedhit, deles dhe të kafshëve të shoqërimit, në stativ, në këmbë dhe në kurriz.
- Mësuesi/instruktori duhet të nxisë diskutimet e nxënësve për përcaktimin e teknikës më të përshtashme për fiksimin e kafshëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer fiksimin e kalit, gjedhit, deles dhe të kafshëve të shoqërimit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryerjen e fiksimit të kafshëve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë me kafshë të llojeve të ndryshme.
 - Orëndi, pajisje dhe vegla të punës për fiksimit.
 - Stativ konstrukcion metalik
 - Dezinfektantë, barna të ndryshme.
 - Peshqire, sapun, kova uji.
 - Mjete për fiksimin e kafshës (litarë, javasha, etj.).
-